



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE NË SLOVAKI SEMESTRI VEROR PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Sllovakinë nëpërmjet Ambasadës së Republikës Sllovaqe, jemi informuar mbi thirrjen e re për aplikime kuadër Programit Kombëtar të Bursave të Republikës Sllovaqe. Kjo thirrje është e hapur për studime, kërkime, mësim dhe qëndrime artistike për vitin akademik 2021-2022.

Afati i aplikimit për bursë është deri **më 31 Tetor 2021, ora 16:00.**

Ky program mbështet lëvizjen e studentëve ndërkombëtarë, studentëve të doktoratës, pedagogëve, studiuesve dhe artistëve për të qëndruar në universitetet sllovaqe dhe organizatat sllovaqe kërkimore.

Bursa mbulon kostot e jetesës për:

- studentët që studiojnë në universitete jashtë Sllovakisë dhe që duan të aplikojnë për 1 - 2 semestra ose 1 - 3 tremujorë në një universitet në Sllovaki gjatë arsimit të tyre të lartë (ose gjatë studimeve master nëse aplikanti ka përfunduar të paktën 3 vite të arsimit të tij të lartë në ditën e fillimit të qëndrimit të tij studimor në Sllovaki);
- Studentët e doktoratës që studiojnë në universitete/organizata kërkimore jashtë Sllovakisë dhe që aplikojnë për një studim dhe/ose qëndrim kërkimor/artistik (1 - 10 muaj) në një universitet ose në një organizatë kërkimore, të ligjshëm për t'u mbajtur nga një program studimi doktorature, në Sllovaki gjatë studimeve të tyre të doktoratës;
- Pedagogë, studiues ose artistë që punojnë në universitete/organizatat kërkimore jashtë Sllovakisë dhe që aplikojnë për mësimdhënie dhe/ose qëndrim kërkimor/artistik (1 - 10 muaj).

Bursa mujore përfshin kostot e akomodimit dhe ushqimit, përkatësisht për:

- Studentët e arsimit të lartë (bachelor + master) - 400 €;
- studentët PhD - 734 €;
- pedagogët, studiuesit ose artistët:
 - pa diplomë doktorature dhe më pak se 4 vjet përvojë pune - 734 €;
 - me diplomë doktorature dhe më pak se 10 vjet përvojë pune - 980 €;
 - me diplomë doktorature dhe më shumë se 10 vjet përvojë pune - 1050 €.

(Shuma e bursës do të mbulojë kostot mesatare të jetesës së mbajtësit të bursës gjatë qëndrimit të tij/saj në Sllovaki.)

Studentët mund të aplikojnë gjithashtu për të përfituar pagesën e udhëtimit, nëpërmjet faqes online www.stipendia.sk.

Shuma e grantit të udhëtimit varet nga distanca (në një linjë të drejtpërdrejtë) midis vendqëndrimit të aplikantit në Sllovaki dhe vendit të tij/saj të origjinës:

- deri në 350 km - 0 €;
- nga 350 në 2.000 km - 250 €;
- nga 2,000 në 7,000 km - 500 €;
- më shumë se 7,000 km - 1 000 €.

Për kryerjen e procedurës së aplikimit online për përfitimin e pagesës së udhëtimit, sistemi hapet të paktën 6 javë para afatit të aplikimit. Aplikimet duhet të dorëzohet në sistemin online të aplikimit deri në afatin e aplikimit.

Kushtet për përfitimin e bursës, përshkrimin e detajuar të programeve studimore, si dhe informacione të tjera gjenden në këtë link: <https://www.scholarships.sk/>

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS